



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 73/16
Prishtinë, më 21 dhe 23 nëntor 2016, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Shukri Buja, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Sali Morina, Shqipe Pantina, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Në mbledhje po ashtu mori pjesë deputeti Ali Berisha (pa të drejtë vote).

Munguan: Jelena Bontić dhe Bali Muharremaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Abdullah Hoti- Ministër i Financave, Agim Krasniqi – Zv. Ministër i Financave, Salvador Elmazi – Drejtor i Departamentit të Buxhetit në MF, Hasan Isufaj- ekspert i financave publike nga GIZ, Pranvera Dobruna – praktikante, Albulena Nuha - gazetare nga RTV 21, Valdete Berisha – gazetare nga Info, Faton Salihu RTK, Florin Ejupi-monitoruese nga BIRN, Dibran Istreti - gazetare në Klan, Norë Shabani - gazetare nga Koha Ditore, Albulena Mavraj - gazetare nga Epoka e Re, Senada Halimi –Zëri, Albulena Misini-gazetare Ekonomia Online, Syzana Bujupi- gazetare nga Rrokum Tv.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj- Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 26.10.2016;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-090 për Sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe amendamenteve të Komisionit funksional për për Legjislacion, Madate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
- 6. Miratimi i Raporti me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-100 për Ndhmën Shtetërore;**

7. **Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168;**
8. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - propozojë që të bëhen disa ndryshime në rendin e ditës: pika e tretë të heqet nga rendi i ditës dhe në vend të saj të futet një pikë e re shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Diasporës për aprovimin e pagesës së paradhënies për financimin Shërbimeve artistike për Ditët e Kulturës Shqiptare në Diasporë.

Enver Hoti – theskoi se po shifet që një pjesë e madhe e partive në pushtet nuk janë të interesuar jo vetëm për Buxhetin por as për funksionimin normal të këtij Komisioni kaq të rëndësishëm. Sigurisht edhe një pjesë e tyre janë në fushatë në Drenas, se atje ka zbarku i gjithë shteti, që nga Kryetari i Kuvendit, Presidenti, ministra e deputetë, kështu që ne vetëm mundemi me ju thanë juve ditën e mirë, sepse ne e shohim të paarsyeshme me qëndru këtu derisa ata janë nëpër fushata.

Shqipe Pantina – është e paktuptimtë që kërkesat kjo qfarë ndodhë me shtyrjen e trajtimit të buxhetit. Buxheti duhet të shkojë në Kuvend në lexim të parë sepse siç e dijmë në këtë fazë në komision mund të ndryshohet asgjë dhe nuk ka arsyeje që të mos shqyrtohet. Qeveria ose ta tërheq buxhetin ose duhet të procedohet në lexim të parë. Nëse nuk diskutohet buxheti unë nuk jamë interesuar dhe nuk do të qendrojë në këtë mbledhje.

Bali Muharremaj – përderisa partitë në pushtet nuk i kanë votat, nuk e dijë pse kërkohet që ne të qendrojmë në këtë mbledhje. Prandaj, unë nuk do të qendrojë në mbledhje në rast se shtyhet pika e buxhetit.

Kryetari konstatoi se në mungesë të korumit, ndërpritet mbledhja e komisionit. Po ashtu njoftojë se për vazhdimin e mbledhjes do t'iu njoftojmë me kohë.

Vazhdimi i mbledhjes së Komisionit, të datës 21.11.2016

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – propozojë që rendi i ditës i datës 21.11.2013, të plotësohet me dy pika të reja të rendit të ditës. Pika e parë: Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Diasporës për aprovimin e pagesës së paradhënies për financimin Shërbimeve artistike për Ditët e Kulturës Shqiptare në Diasporë dhe pika tjetër: Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (aspekti i vlerësimit financiar).

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht miratoi rendin e ditës me ndryshime: Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Diasporës për aprovimin e pagesës së paradhënies për financimin Shërbimeve artistike për Ditët e Kulturës Shqiptare në Diasporë dhe pika tjetër: Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si pika e tretë dhe katërt me radhë.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 26.10.2016;

Kryetari - konstatoi se procesverbali miratohet pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Diasporës për aprovimin e pagesës së paradhënies për financimin Shërbimeve artistike për Ditët e Kulturës Shqiptare në Diasporë

Kryetari - në bazë të 12, paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, Qeveria mund të aprovojë pagesën e paradhënies prej më shumë së tridhjetë përqind (30%) dhe deri njëqind përqind (100%) të vlerës së kontratës për mallra dhe shërbime, vetëm pas rekomandimit nga Komisioni për Buxhet dhe Financa të Kuvendi. Kërkesa e Ministrisë së Diasporës ka të bëjë me aprovimin e pagesës në paradhënie për financimin Shërbimeve Artistike për Ditët e Kulturës Shqiptare në Diasporë. Shuma totale kërkesës për lejimin e pagesës së paradhënies është 17,900 euro. Kërkesës i është bashkëgjitur edhe kontrata e lidhur për ofrimin e shërbimeve të mallrave dhe shërbimeve. Propozojë që komisioni në pajtim me ligjin e buxhetit të përkrah kërkesën dhe ti rekomandojë Qeverisë për miratim.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa, i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës, të miratojë Kërkesën nr. 02/1890, dt.23.11.2016 e Ministrisë së Diasporës, për aprovimin e pagesës së paradhënies në shumë prej shtatëmbëdhjetëmijë e nëntëqind euro (17,900.00 €) që është vlere e njëqind për qind (100%) e kontratës për mallra dhe shërbime, për financimin e “Shërbimeve artistike për Ditët e Kulturës Shqiptare në Diasporë”.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Kryetari – projektligji dhe amendamentet e komisionit nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë dhe ne mund ta procedojmë tutje.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr.05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
 2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, për Projektligjin nr.05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- ### **5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-090 për Sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport**

Kryetari – projektligji në fjalë përmban një kosto shtesë prej 74,700 euro për periudhën 2016-2018, që vlerësojë se është e përballushme për buxhetin e Kosovës. Problemi është tek amendamenti 17 i komisionit funksional, me të cilin janë bërë disa ndryshime në nenin 12 të projektligjit. Paragrafi 1 dhe 2 që janë riformuluar nga ajo që është paraparë me projektligj, nuk janë në rregull dhe në harmoni me legjislacionin tatumor. Prandaj, propozojë që t'i rekomandohet komisionit funksional që ti fshijë këto dy paragraf dhe të mbetet teksti apo paragrafët siç janë propozuar në projektligj.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimit, nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji Nr.05/L-090 për Sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, përmban kosto të përballeshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
 2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, për Projektligjin Nr.05/L-090 për Sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit, 17, paragrafi 1 dhe 2.
 3. Komisioni rekomandon që në amendamentin 17, të fshihet paragrafi 1 dhe 2 dhe të mbeten paragrafët 1 dhe 2, siç janë propozuar me nenin 12 të projektligjit.
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe amendamenteve të Komisionit funksional për për Legjislacion, Madate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit**

Kryetari - projektligji dhe amendamentet e komisionit nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë dhe ne mund ta procedojmë tutje

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimit, nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji Nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
 2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin Nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- 7. Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-100 për Ndhmën Shtetërore**

Kryetari – projektligji dhe amendamentet e propozuara kanë kaluar të gjitha procedurat dhe raporti me amendamentet është i gatshëm për procedim dhe shqyrtim të dytë në seancë plenare. Në ndërkohë kemi pranuar një propozim nga Zyra e BE-së për të bërë një ndryshim në paragrafin 3 të nenit 8, respektivisht që pas fjalës “vendeve të punës”, të shtohen fjalët “,si dhe masat e duhura për evitimin e konfliktit të interesit,”. Arsyetimet janë se me këtë plotësim, bëhet një harmonizim i këtij paragrafi 8.3 me nenin 9.6, respektivisht nenin 25.4 ku parashihen masat për evitimin e konfliktit të interesit të Komisionit të Ndhmës Shtetërore të jenë pjesë përbërse e akteve nënligjore. Po ashtu kërkohet një votim formal i raportit me rekomandime për procedim në seancë plenare.

Kryetari konstatoi se komisioni unanimit për krahu propozimin për ndryshimin në paragrafin 3 të nenit 8, që pas fjalës “vendeve të punës”, të shtohen fjalët “,si dhe masat e duhura për evitimin e konfliktit të interesit,” dhe kjo do të jetë si amendamenti 8 me radhë në raportin final.

Pas diskutimit dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimit, nxori këtë

Raport me rekomandime

I. Miratohet Raporti me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-100 për Ndhimën Shtetërore, me amendamentet si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 1, paragrafi 1, fshihet teksti si vijon: ”me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të dala nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, ku përfshihen dispozitat për ndihmën shtetërore”.

Amendamenti 2

Neni 1, paragrafi 2, në rreshtin e parë, fjala “transponon Rregulloren (BE)”, zëvendësohet me fjalët: “pjesërisht është në përputhje me Rregulloren e BE-së”.

Amendamenti 3

Neni 3, përkufizimi 1.10, riformulohet me tekstin si vijon:

1.10. Ndhimja “De Minimis” - ndihmë me vlerë të vogël që nuk konsiderohet ndihmë shtetërore dhe nuk është subjekt i njoftimit dhe autorizimit të Komisionit.

Amendamenti 4

Neni 4, në rreshtin e dytë, pas referencës “nenit 3”, shtohet referenca “të këtij ligji”.

Amendamenti 5

Neni 6, paragrafi 1, në nënparagrafin 1.3, në rreshtin e katërt, fjalët “aq keq”, zëvendësohet me fjalën “ndjeshëm”.

Amendamenti 6

Neni 6, paragrafi 2, teksti: “me akt nënligjor, në përputhje me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejshëm: BE)”, zëvendësohet me tekstin: “me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria”.

Amendamenti 7

Neni 8, paragrafi 1, teksti: “Departamenti i Ndhimës Shtetërore, si suksesor ligjor i Zyrës për Ndhimën Shtetërore (në tekstin e mëtejshëm: Departamenti) në kuadër të Ministrisë së Financave”, zëvendësohet me tekstin : “Departamenti i Ndhimës Shtetërore (në tekstin e mëtejshëm: Departamenti), themelohet në kuadër të Ministrisë së Financave, i cili”.

Amendamenti 8

Neni 8, paragrafi 3, pas fjalës “vendeve të punës”, shtohen fjalët “,si dhe masat e duhura për evitimin e konfliktit të interesit,”

Amendamenti 9

Neni 9, paragrafi 2, në rreshtin e tretë, fjalët: “të anëtarit të Komisionit”, zëvendësohet me fjalët: “anëtarët e Komisionit”.

Amendamenti 10

Neni 9, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3, riformulohet me tekstin si vijon:

3.3. Kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Amendamenti 11

Neni 9, nënparagrafi 3.4, hiqet.

Amendamenti 12

Neni 10, paragrafi 2, në rreshtin e parë, pas referencës “paragrafit 1”, shtohen fjalët: “të këtij neni”.

Neni 10, paragrafi 2, në nënparagrafin 2.2, në rreshtin e tretë, fjala “justifikohen”, zëvendësohet me fjalën “vlerësohen”.

Amendamenti 13

Neni 11, paragrafi 1, në rreshtin e pestë dhe gjashtë, fjalët: “Opinion paraprak”, zëvendësohen me fjalët: “Komente paraprake”

Amendamenti 14

Neni 11, paragrafi 5, në rreshtin e parë, fshihen fjalët: “dhe çështjet e tjera”.

Amendamenti 15

Neni 12, në rreshtin e tretë, fjala “elemnte”, bëhet “elemente”, si dhe në rreshtin e katërt, fjala “ofrom”, bëhet “ofron”.

Amendamenti 16

Neni 13, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si vijon:

3. Kur një çështje ngrihet në procedurat pranë Departamentit, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e legjislacionit evropian të energjisë, Departamenti, me kërkesë të një pale ose me iniciativën e saj, e njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, në formë të shkruar, në afatin prej 5 (pesë) ditë pune, nga pranimi i çështjes në procedurë. Komisioni në vendimin e tij përfundimtar, duhet të marrë parasysh mendimin e dhënë nga Sekretariati.

Amendamenti 17

Neni 14, në paragrafin 3 dhe 4, referenca me numër “4”, zëvendësohet me referencën me numër “2”.

Amendamenti 18

Neni 15, paragrafi 1, në rreshtin e parë, teksti: “Aty ku Departamenti ka dyshim në përputhshmërinë”, zëvendësohet me fjalët: “Në rast se Departamenti vlerëson mospërputhshmërinë”.

Amendamenti 19

Neni 15, paragrafi 1, në nënparagrafin 1.3, fjala “Kërkon”, zëvendësohet me fjalën “Propozon”.

Amendamenti 20

Neni 15, paragrafi 2, në rreshtin e parë, fshihet teksti “dhe mendimet”.

Amendamenti 21

Neni 16, paragrafi 1, në rreshtin e dytë, pas fjalës “nenit 14”, shtohet fjala “të këtij ligji”. Si dhe në paragrafin 4, në rreshtin e parë, pas fjalës “paragrafit 3”, shtohen fjalët: “të këtij neni”

Amendamenti 22

Neni 17, hiqet.
(Ne vazhdim bëhet rirenditja e neneve sipas radhës.)

Amendamenti 23

Neni 19, paragrafi 1 në rreshtin e dytë, fjala “vëren”, zëvendësohet me fjalën “konstaton”.

Amendamenti 24

Neni 24, paragrafi 2, teksti: “Brenda 3 (tre) muajve nga miratimi i këtij Ligji”, zëvendësohet me tekstin: “Pesëmbëdhjetë (15) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji” .

Neni 24, pas paragrafit 2, shtohet paragrafi i ri 3, me tekstin si vijon:

“3. Pesëmbëdhjetë (15) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, Zyra e Ndihmës Shtetërore, në kuadër të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, shuhet dhe punëtorët e kësaj zyre barten në Departamentin e Ndihmës Shtetërore, në kuadër të Ministrisë së Financave”.

Amendamenti 25

Neni 25, paragrafi 1, në rreshtin e dytë, viti “2020”, zëvendësohet me vitin “2017”.

Amendamenti 26

Neni 26, paragrafi 2, në rreshtin e tretë, pas fjalës “fuqi”, shtohet teksti: “nëse nuk bien në kundërshtim me këtë ligj”.

II. Raporti me amendamente procedohet për shqyrtim në seancë plenare.

8. Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168

Kryetari – projektligji dhe amendamentet e propozuara kanë kaluar të gjitha procedurat dhe raporti me amendamentet është i gatshëm për procedim dhe shqyrtim të dytë në seancë plenare. Kërkohet një votim formal për procedimin e raportit me amendamentet për shqyrtim në seancë plenare.

Pas diskutimit dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Raport me rekomandime

- I. Miratohet Raporti me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168, me amendamentet si në vijim:

Amendamenti 1 - Deputeti Faton Topalli, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Të zëvendësohet emërtimi i Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës me emërtimin « Ligji për Kursimet Pensionale të Kosovës.

Amendamenti 2 - Dy propozime

A) Komisioni FunkSIONAL

Neni 2, paragrafi 1, teksti “zgjedhet vetëm për mandatin e mbetur të anëtarit të dorëhequr apo të larguar”, zëvendësohet me tekstin ”emërohet për mandatin e plotë”

B) Deputeti Faton Topalli, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 4, paragrafi 6 i ligjit bazik ndryshohet si vijon:

« ... Komisioni për përzgjedhje përbëhet nga guvernatori i BQK-së, kryesues, Auditori i Përgjithshëm, ministri i Financave dhe një deputet i Partisë më të madhe opozitare (nënkryetari i dytë i Kuvendit ose kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike)»

Amendamenti 3 - Dy propozime

A). Komisioni FunkSIONAL

Neni 2, paragrafi 2, hiqet.
(Në vazhdim paragrafi 3 bëhet paragrafi 2)

B). Deputeti Faton Topalli, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Të ndryshohet paragrafi 7 i Nenit 4 i ligjit bazik, si vijon:

4.7 Nga pika 4.7 të hiqet pjesa për kompensim prej 50% të anëtarit të qeverisë.

Amendamenti 4

Neni 3, pas paragrafit 2, referenca me numër “2”, bëhet paragrafi me numër “3”

Amendamenti 5 - Deputeti Faton Topalli, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional

7.11... deri në 6 vjet nga viti i pagesës « atëherë kjo shumë e mjeteve shpërndahet proporcionalisht mes të gjithë kursimtarëve të fondit » Pjesa e mbetur e tekstit hiqet nga pika 7.11.

7.12 . Në rast të identifikimit të pagesave pas afatit (6 vjeçar) mjetet e inkasuara sipas paragrafit 11 të këtij neni « merren proporcionalisht prej të gjithë paguesve », së bashku me kamatën ekuivalente me fitimin mesatar që ka pasur Fondi gjatë kësaj periudhe.
(Pjesa i kthehen Fondit... të hiqet nga ligji)

Amendamenti 6

Neni 4, paragrafi 1, teksti : “AA-” ose më lart, dhjetë për qind (10%) për obligacione të vlerësuara “A-” ose më lart, pesë për qind (5%) për obligacione të vlerësuara “BBB-” ose më lart”, zëvendësohet me tekstin: “

“AA” ose më lart, dhjetë për qind (10%) për obligacione të vlerësuara “A” ose më lart, pesë për qind (5%) për obligacione të vlerësuara “BBB” ose më e ultë”

Amendamenti 7

Neni 4, paragrafi 2, shkurtesa në kllapa (“ETFs”), ndryshohet me fjalët “(Exchange Traded Fund)”

Amendamenti 8

Neni 10, në rreshtin e katërt dhe pestë, hiqet fjala “dhe përkatësisht”.

Amendamenti 9

Neni 11, në paragrafin 1, në rreshtin e katërt, fjalët “drejtorëve joekzekutivë”, zëvendësohet me fjalën “bordit drejtues”. Po ashtu në rreshtin e gjashtë të paragrafit 1, “drejtorë joekzekutivë”, zëvendësohet me fjalët “anëtarë të bordit drejtues”

Amendamenti 10

Neni 12, ndryshohet me tekstin si vijon:

Neni 12 Dispozitat kalimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, mandati i anëtarëve aktual të Bordit Drejtues vazhdon deri në skadimin e mandatit të tyre të përcaktuar me Vendimin nr. 04-V-840, datë 6 maj 2014 dhe Vendimin nr.05-V-164, datë 30 nëntor 2015, të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

II. Raporti me amendamente procedohet për shqyrtim në seancë plenare.

9. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

Kryetari - përgatitja e projekt buxhetit të Kosovës për vitin 2017 është bërë në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisitë. Përveç pjesës tekstuale, projektligji e ka edhe pjesën tabelare që përmban të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme të vitit 2017 po ashtu përmban parashikimin e dy viteve në vazhdim. Të hyrat e rregullta buxhetore për vitin 2017 janë planifikuar të jenë në masë prej 1 miliard e 725 milion Euro. Ndërsa shpenzime bazë në vlerë prej 2 miliard e milion euro.

Avdullah Hoti - procesi i përgatitjes së këtij Buxheti ka filluar me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, që është aprovuar në muajin prill të këtij viti. Bazuar në këtë Kornizë, kemi filluar me lëshimin e Instruksioneve Buxhetore. Të gjitha organizatat buxhetore kanë dorëzuar kërkesat e tyre për financim, ndërsa Ministria e Financave ka organizuar dëgjimet buxhetore me përfaqësuesit e këtyre institucioneve, si dhe me shoqërinë civile.

Rrjedhimisht, si rezultat i këtij procesi, Buxheti për vitin 2017 bazohet në parimin e financimit të qëndrueshëm, në njërën anë, dhe financimin e prioriteteve të qeverisë të deklaruara përmes dokumenteve strategjike, siç është Strategjia Kombëtare për Zhvillim, Programi i Qeverisë, Programi për Reforma Ekonomike, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve dhe strategjitë sektoriale.

Ky propozim-buxhet ka pajtimin e plotë të Fondit Monetar Ndërkombëtar në të gjitha pozicionet kryesore buxhetore. Buxheti është ngushtë i lidhur me ecurinë makroekonomike në vend, rajon dhe më gjerë. Mbi këto ecuri, Ministria e Financave ka përgatitur projeksionet makroekonomike dhe fiskale për vitin 2017 dhe vitet në vijim.

Bazuar në vlerësimet e tona në Ministrinë e Financave, ne presim që në vitin 2016 ekonomia të ketë rritje reale rreth 4% dhe kjo pritje është e konfirmuar edhe nga projeksionet e institucioneve të jashtme kredibile, siç është FMN. Ky trend pritet të vazhdojë edhe në vitin 2017, me normë akoma më të lartë të rritjes ekonomike, prej 4.4%. Kjo normë është më e larta në rajon dhe është rezultat i zbatimit me sukses të reformave ekonomike dhe fiskale, që kanë ofruar insentiva fiskale për sektorin privat, si dhe reformave të tjera strukturore të mbështetura nga programi me FMN. Këto reforma u konfirmua tani së fundi në Raportin e të Bërit Biznes të Bankës Botërore, ku Kosova ka shënuar përmirësim të dukshëm në rangim ndërkombëtar. Në veçanti sa i përket reformave në të hyrat në ATK do të rriten në 9% me krahasim këtë vit dhe 23% krahasuar me vitin paraprak dhe në Doganë me 6.5% këtë vit, dhe 16.4% në raport me 2015.

Më lejoni të them se parashikimi për rritje ekonomike prej 4.4% është mjaft konservator dhe nuk përfshinë iniciativat e reja që mund të ndodhin gjatë vitit të ardhshëm. Prandaj, kjo rritje mund të tejkalohet varësisht nga progresi që bëjmë në implementimin e disa projekteve të mëdha që kanë potenciale zhvillimore, si: zhvillimi i kapaciteteve të reja për prodhim të energjisë, që do të krijojë efekte multiplikative, potencialet e krijuara nga Ligji për Investime Strategjike, si dhe potencialet të krijuara nga Ligji i ri për Trepçën.

Sa i përket shpenzimeve për vitin 2017 janë planifikuar prej 2.1 miliard euro dhe krahasuar me vitin 2016 shpenzimet rriten mbi 15%, ndërsa krahasua me vitin 2015, 28%. Shpenzimet rrjedhëse vazhdojmë me i mbajtë nënkontroll dhe kemi krijuar hapësirë më të madhe për shpenzimet kapitale. Ne do të fillojmë implementimin e reformës në sigurimin shëndetësorë ku kemi ndarë të fondi i kontigjentës prej 17 milion euro. Po ashtu kemi bërë të mundur të implementojmë Ligjin për skemat pensionale, kompenzimin për përvojën e punës në sektorin publik, të mbahen në nivel të lartë të subvencioneve në bujqësi, Për kategoritë e veçanta, siç janë veteranët e luftës dhe kategoritë e tjera. Për të mbuluar shpenzimet e nevojshme që dalin obligimet integruese duke përfshirë MSA-në.

Janë paraparë disa projekte kapitale në fushën e shëndetësisë. Në fushën e arsimit parauniversitar ndërtimi i 15 shkollave të reja dhe financimi i gjitha projekteve në vijimë. Në arsimin e lartë parashihet ndërtimi i disa objekteve universiteteve me vlerë prej 4.8 milion euro. Në infrastrukturë janë ndarë

mjetet për financimin e autotradës Prishtinë-Hani i Elezit, është ndarë buxhet adekuat për rrugët rajonale, është planifikuar fillimi Autostradës Gjilan-Prishtinë, janë 90 projekte që i lidhin fshatrat dhe regionet anembanë Kosovës. Po ashtu janë paraparë paisje për ristrukturimin e FSK-së prej 18.5 milion euro, investime në infrastrukturë sportive parashihet stadiumi në Prishtinë, pishina olimpike. Në fushën e trashëgimisë kulturore janë paraparë 2.4 milion euro, në fushën e IT-së, për parkun e biznesit në Drenas.

Sa i përket strukturës së shpenzimeve: pagat e mëditjet arrij deri në 570 milion euro, një rritje 3.8%, mallrat dhe shërbimet i mbajm të kontrolluara 224 milion euro, subvencionet dhe transferet 474 milion euro që janë 1.7% më të larta, investimet kapitale 723 milion euro apo 45% rritje më shumë se në vitin 2016.

Buxheti i komunave merr pjesë në 25.5% e të hyrave të Qeverisë bazuar plotësisht në formulën për grandet komunale dhe të gjitha Komunitatet e kanë aprovuar buxhetin në përputhje me qarkoret buxhetore Buxheti i komunave është në vlerë prej 440.2 milionë euro, që është një rritje prej 15 milionë EUR krahasuar me vitin 2016. Kjo ka ardhur për shkak të rritjes së granteve qeveritare për komuna nga rritja e të hyrave të rregullta buxhetore. Kjo rritje ka shkuar në pjesën më të madhe në rritjen e investimeve kapitale në komuna. Deficitin buxhetor e kemi planifikuar 1.5% të BPV. Deficiti do të financohet nga huamarrja nga emetimi i letrave me vlerë që është planifikuar të jetë 100 mil më 2017, nga disbursimet e huamarrjes së jashtme të kontraktuara që hyjnë brenda kufijve buxhetor të organizatave buxhetore që është 22 milion euro, huamarrja nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare përmes Klauzolës për Investime, në shumë prej 105 milion euro; si dhe të hyrat e privatizimit nga AKP, në vlerë prej 88 milion euro

Safete Hadërgjonaj - ajo çka dua ta them në fillim është shqetësuese kur thoni zoti ministër ju se e kemi të harmonizuar buxhetin me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, me Programin për Zhvillim Strategjik Kombëtar, me Reformën për Ekonomi, dhe kjo nuk qëndron, sepse projektbuxheti na ka ardhur pa treguesit makroekonomik. Nuk mund të miratohet buxheti pa Kornizën makroekonomike dhe këtë e kërkon edhe Ligji për menaxhimin e financave publike, është neni 19 pika 2 që thotë Korniza afatmesme a azhurnuar i bashkangjitet buxhetit. Nuk mundet me qenë një buxhet real pa analizën e trendeve fiskale për të parë se sa janë reale projektisionet makroekonomike dhe sa janë reale projektionet buxhetore të të hyrave.

Buxheti ndryshon nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, të cilin e keni sjell në Kuvend në muajin prill të këtij viti. Pjesën më të madhe të shifrave që kemi në brendi të këtij buxheti, janë kopjim i buxhetit të vitit 2016. 13 organizata buxhetore i kanë të planifikuara cent për cent shpenzimet për mallra dhe shërbime si në vitin 2016. Buxheti nuk hartohet përmendësh e as nuk kopjohet, por hartohet sipas prioriteteve dhe tregueseve makroekonomik mbi bazën e analizave, por për fat të keq këtu nuk është bërë kjo analizë.

Duhet theksuar se buxheti në vitin 2017 ka rritje për 91 milion euro apo 5,5% krahasuar me vitin 2016, siç i kam shënimet në faqen e parë. Në vitin 2016 buxheti ka pas rritje për 160 milion euro krahasuar me vitin 2015, kurse në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014, ka pasur rritje për 125 milion euro.

Ju keni thënë se buxheti do të ketë të hyra prej 1 miliard e 725 milion euro, ndërsa shpenzimet 2 miliard e 1 milion euro. Në kishim dashtë me pas buxhet 3, 4 apo 5 miliard, por kur e keni hartuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, a nuk e keni ditur se mundeni me marrë të hyra nga AKP-ja, që nuk janë planifikuar? Rritja e shpenzimeve si rezultat i huazimeve e rrit borxhin që ngarkon gjeneratat e ardhshme me kalkulimet që duhet bërë për të hyrat nga AKP-ja prej 88 milion euro përmes likuidimit, edhe ju vet e dini se është vështirë me u realizue.

Sa është realizu huamarrja në vitin 2016 dhe sa është vlera e mjeteve që është shpenzuar nga huamarrja e cila është shpenzuar për projekte kapitale? Nga Raporti i Zyrës së Audimit në vitin 2015 kanë qenë të planifikuara 107 milion euro për me u realizu përmes huamarrja e me u shëndrru në projekte kapitale dhe janë realizuar vetëm 45 milion euro dhe nga këto mjete janë shpenzuar vetëm 6 milion e 750 mijë euro për projektet kapitale, dhe mirë është me na shpjeguar rrjedhën e huamarrjes dhe nivelit të

shpenzimit të mjeteve, që të jemi të bindur me këto planifikime që i keni bërë në buxhet. Po ashtu është mirë më e ditë se çfarë kriteri keni përdorur për realizimin e huamarrjes së brendshme? Po e shoh se huamarrja në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 është rritur për 174 milion euro, ne e dimë që kemi pas nivelin e ulët të borxhit por nëse shkojmë kështu me këtë trend kemi me tejkalu çdo kufi.

Në Ministrinë e Infrastrukturës keni planifikuar për të shpenzuar mjete prej 258 milion euro, prej të cilave 244 milion euro janë të bartura nga viti i kaluar, kurse 14 milion janë projekte të reja. Prej 90 projekteve të reja, 60 prej tyre janë të planifikuara me shuma prej 50,000 euro.

Tani po e shtoj një pyetje: çfarë është bërë me nenin 13, pika 6 të projektligjit, ku është thënë se nuk mundet të nënshkruhet asnjë kontratë për një projekt për të cilin kërkohet financim me shumë se një vit pa vendim të qeverisë. Një rregullim i tillë po ndikon që po planifikohen projete me shuma të vogla që janë të pazbatueshme, siç është rasti i Projektit të Rrugës Deçan-në kufi me Malin e Zi, ku janë planifikuar vetëm 50,000 euro. Tek Ministria e Kulturës asnjë projekt nuk është për stadiumet që na kërkon UEFA dhe FIFA, por kjo ministri ka hequr edhe 12 projekte tjera nga viti i kaluar që janë realizuar.

Planifikimi në nënkategori të shpenzimeve rrjedhëse sipas nenit 14, a mund të buxhetosh në këtë formë zoti ministër, a e keni pas parasysh kur e keni hartuar këtë nen gjatë planifikimit të buxhetit? A mund të dini psh. sa konferenca keni me marrë pjesë ju si ministri jashtë vendit? A e ke planifikuar se sa mjete të duhen për server në ministri, si në vitin e kaluar nuk ka qenë një planifikim i tillë?

A është bërë ndonjëherë ndonjë analizë e kostos së buxhetit për projekteve kapitale, se çfarë shpenzime bartë projekti tre vjet pas përfundimi? Duhet me tregue sa është numri i të punësuarve me kontrata të rregullt dhe sa janë me kontrata mbi vepër dhe sa i kushton qeverisë të punuarit me kontrata mbi vepër si është planifikuar kjo shuma e kontratave mbi vepër në buxhet? Sa mjete janë ndarë për zbatimin e Ligjit për gratë të cilat kanë pësuar dhunë gjatë luftës? Është mira na shpjegu për kontigjencen kapitale në ministrinë tuaj për mjete e AKP-së prej 24 milion euro ku kanë me shkuar? A janë ndarë mjete për zbatimin e Ligjit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe ku janë të përfshira këto mjete?

Unë kam shqetësim tek Ministria e Shëndetësisë, buxheti është rritur vetëm 272,160 euro, ku numri i të punësuarve është rrit për 27, ndërsa masa e pagave është zvogëluar për 922,855 euro. Po ashtu investimet kapitale tek kjo ministri janë zvogëluar për 1 milion e 390 mijë euro. A mund të na shpjegoni si po shkon zhvillimi i mjeteve për fondin zhvillimor për pjesën veriore të Mitrovicës? Po ashtu të na njoftoni cilat projekte do të mbulohen me klauzolën e investimeve dhe të përfshihen në pjesën ku është e përshkruar tek investimet kapitale? Ju kisha lutur zoti ministër që Kornizën e Afatmesme të Shpenzimeve ta punoni t'ia bashkangjiti buxhetit para se me shku në seancën plenare.

Avdullah Hoti - Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike e kemi dorëzuar në Kuvend në muajin prill, pasi që është aprovuar në Qeveri. Normalisht ne e kemi kornizën e rishikuar, në bazë të të cilës e kemi përgatit këtë buxhet dhe është e gatshme. Por që ta qartësojmë ne e kemi dorëzuar projektbuxhetin në Kuvend ashtu siç e kërkoi ligji, por nëse është kërkesë e juaja ne do të dorëzojmë edhe kornizën makro-fiskale dhe brenda ditës.

Janë 13 organizata që e kanë buxhetin e njëjtte për mallra dhe shërbime, por unë mendoj se është informatë e mirë për juve sepse ne po i mbajmë nënkontroll shpenzimet konkret me cilësi të njëjtë të shërbimeve. Rritja e Bruto Prodhimit Vendor (BPV), ka qenë shumë më e vogël në 1.2% në vitin 2014, në tri vitet e ardhshme ne e kalojmë 4% si rritje ekonomike, ndërsa huamarrjen e brendshme e mbajmë mbi 100 milion euro, kurse huamarrjen e jashtme e rrisim 105 milion euro brenda vitit, ne përputhje me marrëveshjen e FMN-së. Brenda vitit borxhi publik nuk rritet me shumë se 1.5%, sepse kemi BPV-në mbi 4% , dhe kur krahasohen si përqindje e mbajmë borxhin në 14% që është më se e përballueshme edhe për dy gjeneratat e ardhshme dhe krahasuar në vende tjera që kanë një borxh publik 60 apo 70%. Ministria e Infrastrukturës e merr pjesën më të madhe të buxhetit, kjo është për shkak që është nënshkruar kontrata për ndërtimin e autostradës për Shkup dhe ne kemi obligime shtetërore që duhet të kryjmë. Rruga për Pejë, Skenderaj, Drenas dhe shumë rrugë tjera që nuk janë rrugë të lokale por janë

rruge të mëdha. Janë propozuar projekte të reja që lidhin rrugët lokale me fshatrat e tjera dhe janë të paraparë në kornizë për tri vitet e ardhshme. Ne e kemi futur në buxhet kësaj radhe që asnjë kontratë të mos nënshkruhet nëse nuk është reflektuar plotësisht me kornizën buxhetore, që të mos lejojmë lidhje të kontratave nëse nuk janë mjetet të alokuara në 2017 ose të parapara një 2018 dhe 2019 dhe kjo e parandalon rritjen e obligimeve pa mbështetjen shtesë buxhetore.

Në Ministrinë Kulturës, e kemi qartësu me ministrin, ku ka disa mjete që janë bartur në këtë ministri në rishikim të buxhetit janë duke u implementuar. Tek kategorizimi i shpenzimeve rrjedhëse në nivel pesë shfitor kjo është një reformë në financat publike dhe unë pres që të na mbështetni në këtë drejtim sespe kjo përfundimisht e vendos kontrollin e shpenzimeve publike.

Për mjetet për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik janë te parapara 1.8 milion euro, ligji ka disa implikime buxhetore dhe do ta trajtojmë së bashku. Sa i përket mjeteve të AKP-së jemi konsultuar me bordin e kësaj agjencie. Fondi për Veriun, jemi duke e menaxhuar në përputhje me marrëveshjen e 2013 dhe Ligjin e buxhetit në baza vjetore.

Safete Hadërgjonaj – në nenin 19.2 të Ligjit për menaxhimin financave publike dhe përgjegjësitë, thuhet që Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e azhurnuar i bashkëngjitet buxhetit. Nëse krahasojmë KASH-in e muajit prill dhe këtij buxheti kemi shpërputhje të mëdha në planifikimin e shpenzimeve. Sa i përket nivelit të borxhit nuk është i lartë, por trendi i rritjes që është bërë prej 177 milion euro është një trend i nxituar dhe i shpejtuar. Tek planifikimi pesëshifro urojë që ju të mundeni ta bëni një gjë të tillë, por është e vështirë e realizueshme dhe pastaj kemi me marrë vërejtje nga raportet e ndryshme që nuk kemi mundur me realizue. Tek planifikimi për mallra e shërbime, unë jam shumë e interesuar të zvoglohen këto shpenzime, por planifikimi identik, pa lëviz as një cent dhe kopje si vitin e kaluar është i pakuptueshëm.

Shqipe Pantina- kur po i dëgjoja vërejtjet dhe komentet e Safetës, që po besojë se nuk janë vërejtjet e saj individuale, por qëndrimet e subjektit politik, atëherë po me krijohet përshtypja se a ka kaluar ky buxhet në Qeveri apo jo? A kanë qenë prezent në atë takim ministrat edhe zv. kryeministri nga PDK, apo thjesht ka marr shumicën e votave të LDK -së dhe komuniteteve?

Me disa vërejtje që i ngriti Safetja, pajtohem dhe unë. U bënë disa vite pas pavarësisë ku Qeveria vet harton ligje, por ende shihen gjurmët pashlyeshme prej kohës së UNIMK-ut, kjo shifet edhe në rastin e hartimit të këtij draft buxheti, ku teksti është shkruar në anglisht e pastaj është përkthyer në shqip, dhe këto janë vërejtje teknike, por për mua krijojnë një përshtypje tjetër. Shifra e shpenzimeve prej 2.1 miliard euro është joreale edhe pse në fakt nevojat në Kosovë janë shumë më të mëdha, ndoshta për 5 miliard, por çështja është a janë ngrit të hyrat? Jam munduar me i kalkulu me dorë dhe me mjete elektronike por këta numra asesi nuk përputhen dhe nuk del shuma ajo çfarë e keni dhënë këtu. P.sh. të të hyrat tatimore që janë të hyrat direkte dhe të hyrat jodirekte, shuma 1 miliard 512 milion, mua po më del 1 miliard 543 milion, edhe nëse zbritet shuma prej 44 milion euro nga kthimet tatimore, prapë nuk më del e njëjtë. Safetja e ngriti çështjen e Fondit të Veriut, nuk është treguar se ku kanë me shkuar ato shpenzime.

Tek Ministria e Infrastrukturës janë 52 projekte të reja dhe shuma e tyre është 50,000 euro. Pse duhet të fillohen 52 projekte menjëherë e nuk mbarojnë për tri vite, përderisa kanë mundur të fillojnë disa projekte që mundën me perfundu brenda një viti? Nëse nuk janë zgjedhjet vitin tjetër ato do jenë në vitin 2018 dhe një Qeveri e re mund të mos e ketë prioritet asfaltin, por ka prioritet arsimin, shëndetësinë, e fusha tjera dhe ju qeveritë e ardhshme po i fusni në borxhe.

Tek buxheti i komunave dhe hartimi i tyre, do duhet me qenë një formë e njëjtë se si i dërgojnë ato në ministri. Pasi që për investime kapitale, disa komuna japin detale e disa tjera nuk kanë i projektet se si kanë me i shpenzue mjete, dhe do të duhej të ekzistojë një udhëzues që krejtë komunat me prezentue buxhetin në një formë të caktuar në Qeveri.

Fondi për sigurimet shëndetësore që është paraparë tek shpenzimet kontigjente në ministrin e financave, dhe meqë është paraparë të filloj me Ligjin e buxhetit 2017, pse shuma nuk është alokuar tek

institucionet por ka mbet tek fondi? Edhe në vitin 2017 parashihen shuma të njëjta për gjyqësorin. E dimë që pika me e dobët është gjyqësori, dhe për me forcë gjyqësorin duhet me e rrit buxhetin. Kam një pyetje tek Kuvendi, buxhetin e të cilit e kemi miratuar në komision me rastin e shqyrtimit të qarkores së dytë, dhe ka qenë një vijë buxhetore të cilin nuk e kemi kalu, kanë qenë 140,000 euro tek subvencionet dhe transfere dhe këtu prapë po figuron, çka ka ndodh? Si rezultat i MSA-së, të hyrat doganore do të zvogëlohen, si do të zëvendësohen ato të hyra, sepse nuk është shumë qartë në këto shifra?

Ali Berisha- shihet se ky buxhet nuk e merr për bazë strategjinë zhvillimore të Kosovës që tregon se nuk është real dhe është diskrepant. Te hyrat dhe shpenzimet nuk janë të balancuara, 100 milion në shpenzime të planifikuara nga letrat me vlerë, e 88 milion nga AKP-ja, në cilën bazë ligjore mbështeteni për ti tërhequr këto mjete?

Buxheti i planifikuar për tri vitet e ardhshme nuk e krijon një mbështetje për krijimin e ushtrisë së Kosovës? Në arsim është premtuar ngritja e cilësisë, ndërsa planifikimet buxhetore nuk e sigurojnë një gjë të tillë. Të gjitha qeveritë e theksojnë që është prioritet shëndetësia dhe buxheti që planifikohet për këto tri vite nuk e sheh si prioritet këtë sektor. Në Gjakovë është një spital që janë krenuar me të sidomos kohën e paraluftës, e sot është në një situatë të keqe, sepse pacientet emergjent trajtohen nëpër korridore, dhe menaxhmenti i atij spitali ka një projekt të mirë për ndërtim të spitalit të ri edhe mjetet e shëndetësisë nuk planifikohen për ndërtim në atë lokalitet. Po ashtu te kjo Ministri, nuk është e planifikuar ndarja buxhetore për specialistët, që është një numër i madh që presin zgjidhje.

Tek shpenzimet e kapitalet sipas klauzolës së investimeve të planifikuara janë diku 105 milion, a është i supozuar apo real nëse bazohemi në planin e buxhetit? Është fakt i madh se keni planifikuar shumë projekte në shumë prej 50,000 euro, por pse të bëhet ky planifikim apo keni nis gjithkrah projekte për vota dhe në fund lihet për realizim në vitin e ardhshëm. Në këtë formë nuk përmirësohet jeta e qytetareve e nuk ka zhvillim ekonomik e as punësim të qytetareve.

Enver Hoti – mendojë se patëm rast të dëgjojmë një debat retorik në mes znj. Hadergjonaj dhe Ministrin dhe atë si pretext për të shfaqur pazaret politike për arritjen e mbështetjes së buxhetit. Ministri tha se buxhetit i vitit 2017 do të jetë me rritje prej 91 milion euro më shumë në krahasim me vitin 2016, por nuk na ka thënë se kjo vjen prej rritjes së normës së TVSH-së dhe rritjes e akcizave që ka ndodhur. Diferenca mes të hyrave buxhetore dhe shpenzimeve është 276 milion euro, shuma po pretendohet të mbulohet nga huamarrja, dëshmon se po e fusni Kosovën në borxhe publike.

Për kategorinë paga dhe mëditje në vitin 2017 krahasuar me 2016 ka një rritje prej 3.2 % më shumë se në vitin e aktual, por kjo kuptohet se kjo qeveri nuk zbaton rekomandimet nga Raporti i Progresit dhe mendoj se e rëndon buxhetin e shtetit duke i kthyer institucionet publike në ndërmarrje të punësimit të nepotizimit politik e familjar. Sa zëvendës-ministra kemi, ju lutem na tregoni? Tek kategoria mallra dhe shërbime, Qeveria juaj është kujdesur për luksin e saj, ka planifikuar një rritje për 17 milion euro. Janë shpenzime që do ta rrisin luksin e juaj e nuk ka kurrfarë faktori dominues në rritjen ekonomike. Në subvencione dhe transfere, keni pasur një rritje prej 8 milion euro dhe kjo Qeveri ka krijuar mundësinë e keqmenaxhimit dhe keqpërdorimit të këtyre mjeteve financiare, pa procedura ligjore dhe ky fond buxhetor është planifikuar tek Kryetari i Kuvendit edhe tek ministrinë.

Tek Ministria e Bujqësisë planifikimi i buxhetit është bërë duke shpërndarë mjetet me procedura të shpejta tek militantët e partisë në pushtet. Mënyra e planifikimit të investimeve publike tregon për një shpërndarje jo profesionale të nivelit të investimeve dhe ju e dini që disa komuna kanë përfituar por disa jo, duhet me na dhënë një arsye pse? Investimet në Ministrinë e Infrastrukturës i keni futur disa rrugë lokale me ka 50,000 euro me i mashtruar qytetarët.

Kisha propozuar që të kthehet në rishqyrtim ky buxhet. Te rishikohet planifikimi i shpenzimeve duke u bazuar në nevojat dhe prioritetet e jo në shpenzime kopje nga viti aktual. Shpërndarja buxhetore të jetë shpërndarje proporcionale. Të respektohet çelësi tek numri i banoreve, sepse ka komuna që janë te

diskriminuara. Të bëhet një rishikim i buxhetit për të gjitha kategoritë ekonomike. Po ashtu të Kuvendi të rishikohet shuma për subvencione prej 140,000,se ju e dini se ne si komision nuk e kemi votuar.

Besa Gaxheri – qytetarët e Kosovës duhet me e ditë që për herë të parë kemi një buxhet zhvillimor dhe këtë nuk duhet ta mohoj askush. Ne i dijmë procedurat e përgaditjes së buxhetit, ku përfshihen të gjitha organizatat buxhetore në këtë proces i udhëhequr nga ministria e financave dhe të gjithë ministrat e linjës kanë qenë pro këtij buxheti dhe e kanë votuar në Qeveri. Natyrisht se ka hapësirë për diskutime dhe përmirësime të nevojshme dhe ne kemi mundësinë të shqyrtojmë kërkesat e arsyeshme dhe të propozojmë amendamentet e nevojshme. Por, nuk mundet askush të mohojë që ky buxhet që ka vlerën shpenzimeve prej 2 miliard 1 milion euro që nuk zhvillimor.

Në paga ka rritje 3%, shpenzime operative 8%, investime kapitale 45% , transfere janë vetëm 1.7% dhe kjo i thotë të gjitha. Ajo që është për tu vlerësuar se ky buxhet është hartuar në mbështetje të plotë të FMN-së. Ne javën e kaluar kemi pasur takim me misionin e FMN-së si komision, dhe keni munguar pothuasje se të gjithë anëtarët dhe ne kemi marr informata prej FMN-së që e mbështesin plotësisht këtë buxhet. Ne e përgëzojmë punën e ministrit dhe ekipit të tij, por nuk duhet të lejojmë që të bëhet as fushatë e as marketing me buxhet. Po e mbylli me porosinë se ne jemi këtu për bërë çdo plotësim dhe ndryshim të nevojshëm, por për qytetarët vërtetë duhet t'iu themi se Kosova ka marr rrugën e zhvillimit.

Shukri Buja – unë mendoj se ky buxhet nuk është zhvillimor. 45% e investime kapitale planifikohen të financohen prej huamarrjes. Buxheti real është 1 miliard e 750 milion euro, pjesa tjetër është ne huamarrje që bënë të rritet në 2 miliard e 1 milion dhe buxheti me huamarrje dhe me borxhe nuk bëhet. Shumica e buxhetit shkon për asfalt dhe për të qenë buxheti zhvillimor shpenzimet duhet të orientohen më shumë fushat që do të kenë efekt në zhvillimin ekonomik, si energjia, bujqësia. Buxheti është elektoral. Ligjin për veteranët e luftës si dhe ligjet tjera që janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës duhet me zbatue dhe duhet të ndahen mjetet e mjaftueshme. Buxheti përmes të hyrat burimore siç është TVSH-ja i ngarkon bizneset, por edhe për qytetarët. Kemi pas një trysni e presion të madhë për me mbledh taksa e tarifa për me e mbush buxhetin e Kosovës. Nëse ministrat e kanë aprovuar buxhetin ata munden me gab , siç edhe kanë gabu. Por, unë jam insistues që ky buxhet të mosaprovohet në Kuvend dhe le t'iu kthehet Qeverisë për ripunim.

Avdullah Hoti - ky buxhet është i dakorduar me FMN-në dhe Komisioni Evropian dhe ky është buxhet konservator, i mundshëm edhe i arsyeshëm dhe nëse FMN-ja pajtohet me këtë buxhet që është konzervator jam i bindur që mundemi ta realizojmë. Komunat janë autonome ne buxhetin e tyre ato parashikojnë siç e shohin të arsyeshme. Formula e grandeve komunale zbatohet pikë për pikë sipas kritereve të përcaktuara me ligj. Te fondi i sigurimeve shëndetësore mjetet mbesin në ministrinë financave dhe do të shpërndahen për të gjitha ministrinë dhe komunat sepse këto me një vend paguhen të gjitha. Sa i përket projekteve kapitale, asnjëherë nuk keni pasur shpërndarje të projekteve kapitale me të saktë nëpër komuna. Buxheti për organet e drejtësisë është rritur dhe është më i madh se sa ka qenë. Në Këshillin Prokurorial të Kosovës buxheti është rritur për 11.9%, në Këshillin Gjyqësorë të Kosovës për 5%, në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka një rritje prej 2.9%, në FSK 8.7% dhe krejt kjo rritje shkon për paisje që i ka FSK-ja dhe shndërrimin e saj në ushtri. Vlerësimet për të hyrat vetanake i marrin efektet e MSA-se, përndryshe do të kishim buxhet dhe për 60 milion euro shtesë.

Të hyra e rregullta tatimore janë për 300 milion euro më shumë për dy vite dhe këto janë rezultate të njohura. Subvencionet ne bujqësi janë të aprovuara me një proces transparent. A është buxhet elektoral unë mendoj se se çdo vit është buxheti është elektoral, sepse i përmbush politikën dhe programet që qeveritare që janë në interes të qytetareve. Ne kemi premtuar që çka do të bëjm në vitin e parë, të dytë dhe tretë, dhe njëra ka qenë që do e mbërrimë buxhetin ne 2 miliard euro, në gjysmë të mandati dhe kemi bërë. Kemi premtuar përmirësime në shëndetësi e kemi mbërrirë, kemi premtu se do të fillojmë autostradën për Gjilan dhe rrugën për Podujevë e kemi mbërrirë. Janë të gjitha këto premtime elektorale që po realizohen përmes buxhetit.

Kryetari – sa i përket shumës së buxheti të Kuvendit, respektivisht shumës tek kategoria subvencione dhe transfere, gjatë shqyrtimit të qarkorës së dytë buxhetore ne nuk e kemi përkrahur si komision, por kërkesat e Kuvendit kanë shkuar në Qeveri me vonesë pasi që është përmbyll drafti dhe Ministria e ka marr në konsideratë qysh ka qenë e planifikuar në qarkoren e parë dhe tash do ta kemi përsëri edhe do te diskutohet. Unë konsideroj qe kemi debat mirë dhe kemi me pas mundësi si deputet, si Komision me i disku ato qe janë të domosdoshme dhe me prozue ndryshimet e nevojshme. Ne do të ndahemi në grupe punuese për të shqyrtuar buxhetin dhe kërkesat buxhetore, dhe do të angazhojmë një ekspert për me u marr me analizimin e kërkesave buxhetore. Tani propozojë që ti rekomandojmë Kuvendit për miratimin e Buxhetit 2017 në lexim të parë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit të Kryetarit, Komisionit me pesë vota Për, tri Kundër dhe asnjë Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë në parim Projektligjin nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Mbledhja përfundoi në ora 12:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani